

**VENDIM**  
**Nr. 122, datë 9.6.2025**

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN MAJ 2025 PËR KLIENTËT E  
LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 KV**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.6.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1809/1 prot., datë 5.6.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin maj 2025 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

**I. Aspektet ligjore dhe procedurale**

**1. Paraqitja e kërkesës nga FSHU sh.a.**

Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 3360 prot., datë 2.6.2025, protokolluar në ERE me nr. 1809 prot., datë 3.6.2025, ka depozituar kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin maj 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

**2. Procesi i shqyrtimit të dokumentacionit nga ERE**

Kërkesa është shqyrtuar në përputhje me nenin 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe “Metodologjisë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar.

**II. Analiza e përlllogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin maj 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV**

**1. Blerja e energjisë në bursë**

Për muajin maj 2025, FSHU sh.a. ka siguruar sasinë e nevojshme të energjisë elektrike për këtë kategori klientësh përmes blerjeve mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX), duke u bazuar në profilet ditore të prokuruar, çmimet ditore/orare dhe vlerat përkatëse të faturuara.

**2. Përlllogaritja e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes (ÇBET)**

Bazuar në të dhënat e paraqitura, FSHU sh.a. ka përlllogaritur çmimin mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për muajin maj 2025 në vlerën 8.17 lekë/kwh. Kjo vlerë është verifikuar edhe nga ERE, nëpërmjet një rillogaritjeje, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është 8.17 lekë/kwh, në përputhje me përlllogaritjet e paraqitura nga shoqëria.

**3. Komponentët sipas metodologjisë (neni 8, vendimi nr. 201, datë 4.12.2017, i ndryshuar)**

Në përputhje me metodologjinë përkatëse, komponentët e përdorur për përlllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike janë si më poshtë:

- **Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBET) për muajin maj 2025: 8.17 lekë/kwh;**

- **Tarifa e shërbimit të transmetimit** të energjisë elektrike për periudhën 1 shkurt 2025–31 dhjetor 2027, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 279, datë 16.12.2024: **0.85 lekë/kwh;**

- **Tarifa e shërbimit të shpërndarjes** në nivel tensioni 35 kV, sipas vendimit të Bordit të ERE nr. 288, datë 23.12.2024, “Mbi lënie në fuqi të vendimit të Bordit të ERE nr. 73, datë 13.4.2022”: **1.55 lekë/kwh;**

- **Kostot administrative:** **1.06 lekë/kwh;**

- **Kurset zyrtare të këmbimit** të publikuara nga Banka e Shqipërisë (lekë/euro), për çdo datë respektive në harkun kohor **30.4.2025–30.5.2025.**

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të FSHU sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin maj 2025, përllogaritet si më poshtë:

| <i>Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin maj 2025</i> |                 |              |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|--------------|
|                                                                                                                                                             | <i>Njësia</i>   | <i>Çmimi</i> |
| CBEt Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike                                                                                             | Lekë/kWh        | 8.17         |
| Pr Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)                                                                                               | Lekë/kWh        | 0.25         |
| CA Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit                                                                                               | Lekë/kWh        | 1.06         |
| TRr Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit                                                                                                          | Lekë/kWh        | 0.85         |
| TSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes                                                                                                         | Lekë/kWh        | 1.55         |
| <b>Çmimi i energjisë = CBEt + Pr * CBEt + TRr + TSHt + CA</b>                                                                                               | <b>Lekë/kWh</b> | <b>11.88</b> |

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë 11.88 lekë/kwh për muajin maj 2025.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin maj 2025 prej 11.88 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për kategoritë e klientëve të cilësuar në këtë vendim, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga Bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti